




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.49/2024  
Datë: 22 shkurt 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1, nën paragrafi 1.14 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 3 paragrafi 1, pika 1.3, neni 7 dhe 8 të Rregullores Nr. 08/2022 për Transferimin e Gjyqtarëve, në takimin 321-të, të mbajtur me datë 22 shkurt 2024, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e znj. Pajtesa Fera, gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj për transfer të përhershëm në Gjykatën Themelore Prishtinë – dega Lipjan.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 22 shkurt 2024

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 25 janar 2024, ka pranuar kërkesën e Pajtesa Fera, gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj, e dekretuar më datë 16 janar 2024 për transfer të përhershëm në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega në Lipjan. Kërkesën e saj e ka mbështetur në arsyjet familjare si dhe çështjes së vendbanimit.

Pas shqyrtimit të kërkesës së znj. Fera, Këshilli konkludoi se në rastin konkret gjyqtarja ka kërkuar transferim të përhershëm i cili transferim në bazë të legjislacionit në fuqi realizohet përmes një konkursi të brendshëm të shpallur nga KGJK-ja.

Poashtu gjyqtarja në fjalë sapo është dekretuar gjyqtare me mandat fillestar dhe nuk ka të përfunduar trajnimin fillestar në Akademinë e Drejtësisë, i cili është kusht për realizimin e këtij transferi. Kjo situatë e bën kërkesën e saj të përjashtohet nga mundësia e transferimit sipas dispozitave dhe kërkon një pritje më të gjatë derisa të plotësohen kriteret e nevojshme për transferim. Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Znj. Pajtesa Fera;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Arkivit të KGJK-së.